

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: PASTER IN SH.P.K.; BENI TRADE GROUP SH.P.K. me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **25.05.2026**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **PASTER IN SH.P.K.; BENI TRADE GROUP SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"**, me Numër të prokurimit: **623-26-2185-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-009-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **PASTER IN SH.P.K.; BENI TRADE GROUP SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"**, me Numër të prokurimit: **623-26-2185-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-009-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.05.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-2185-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-009-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: **PASTER IN SH.P.K.; BENI TRADE GROUP SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"**, me Numër të prokurimit: **623-26-2185-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-009-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.05.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarohet se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II.

Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04/L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>;

Dëshmia 1: Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04/L-042, Plotësimi I Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit;

Sqarimet janë si në vijim:

Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit është publikuar me datë: **14.04.2026** dhe Hapja e Tenderit është bërë me datë: **04.05.2026**

Në ofertën e juaj të dorëzuar, **data e cekur tek Deklaratën nën betim nga Lideri dhe Anëtari i Konzerciumit është bërë me datë: 13.05.2026**, ndërsa sipas Njoftimi për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit data e fundit e Deklaratës nën Betim **duhet te ishte deri me: 04.05.2026**, andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform LPP-së**

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

PRETENDIMI NR.1

Pretendimi nr.1 ka të bëjë me eliminimin e ofertës sonë edhe pse ne jemi GOE I përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Në letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, thuhet që oferta e juaj është eliminuar sepse nuk kemi përmbushur kërkesat e përshtatshmëris siq është Deklaratë nën Betim e cila ka datën 13.05.2026, e që në fakt do të duhet të ishte 03.05.2026, pra kemi të bëjme me një gabim teknike jo diçka thelbësore sa për të dëmtuar buxhetin e AK. Deklarata nën Betim e dorëzuar nga ne si GOE përmbushë të gjitha kërkesat siq parashihet me nenin 65 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, keni cekur: *Në letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, thuhet që oferta e juaj është eliminuar sepse nuk kemi përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë siç është Deklaratë nën Betim e cila ka datën 13.05.2026, e që në fakt do të duhet të ishte 03.05.2026, pra kemi të bëjmë me një gabim teknike jo diçka thelbësore sa për të dëmtuar buxhetin e AK. Deklarata nën Betim e dorëzuar nga ne si GOE përmbushë të gjitha kërkesat siç parashihet me nenin 65 të LPP-së.*

Në **Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, kemi sqaruar se Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit është publikuar **me datë: 14.04.2026** dhe Hapja e Tenderit është bërë **me datë: 04.05.2026**

Në ofertën e juaj të dorëzuar, data e cekur tek **Deklaratën nën betim nga Lideri dhe Anëtari i Konzerciumit** është bërë me **datë: 13.05.2026**

Deklaratën nën betim nga Lideri Konzerciumit

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: PASTER IN SHPK deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	PASTER IN SHPK
Adresa e plotë:	Rohevec
I përfaqësuar nga:	
Emri	Hana Haxhijaha
Pozita	PRONAR
Nënshkrimi	
Data	13.05.2026
Vula	

Deklaratën nën betim nga Anëtari i Konzerciumit

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: **BENI TRADE GROUP SHPK** deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	BENI TRADE GROUP SHPK
Adresa e plotë:	RR.ABDYL RAMAJ NR 36
I përfaqësuar nga:	
Emri	ARBEN KUQI
Pozita	PRONAR
Nënshkrimi	
Data	13.05.2026
Vula	

Ku dokumenti në fjale, **nuk mund të kërkohej në baze të Nenit 72, paragrafi 3.** ku thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

PRETENDIMI NR.2

Pretendimi nr.2 ka të bëjë me ofertën e GOE të rekomanduar, të cilin grup AK e ka vlerësuar si të përgjegjshëm edhe pse nuk ka plotësuar kërkesën e përshtatshmërisë profesionale.

Në FDT të kërkesa nr.2 e përshtatshmërisë profesionale AK ka kërkuar që OE të dorëzojnë si dëshmi “Certifikatën e TVSH – Kopje”:

Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së

Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje

Në bazë të verifikimit të ofertës së GOE, Lideri nuk e plotëson këtë kërkesë, andaj GOE I rekomanduar është dashur që të eliminohet e jo të rekomandohet. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e grupit, në këtë rast edhe Lideri. Neni 71 I LPP-së ka specifikuar që këto kërkesa duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e grupit.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur **me pretendimin tuaj ankimor**, për Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë **është i pabazuar**.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, keni cekur: *Në bazë të verifikimit të ofertës së GOE, Lideri nuk e plotëson këtë kërkesë, andaj GOE i rekomanduar është dashur që të eliminohet e jo të rekomandohet. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e grupit, në këtë rast edhe Lideri. Neni 71 I LPP-së ka specifikuar që këto kërkesa duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e grupit.*

Sa i përket Certifikatës së TVSH – së, nga Lideri i Konzerciumit, këtë dokument mund te verifikoni edhe ne linkun: <https://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/Index>

REZULTATET

Nr. Fiskal

810733106

NRB

810733106

Status

Emri

GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K.

Adresa

Sheshi Ilmi Maliqi, pn

Qyteti

RAHOVEC

Komuna

RAHOVEC

Qendra Tatimore

PRIZREN 2

Nr. TVSh

330040197

Statusi në TVSh

DEKLARUES I TVSH

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

PRETENDIMI NR.3

Po ashtu AK ka vperuar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së kur e ka vlerësuar të përgjegjshëm GOE të rekomanduar, sepse I njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën nr.1 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të FDT, në të cilën kërkesë AK ka kërkuar specifikisht dëshmitë sin ë vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar për kryerjen punëve shërbimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani;

Dëshmia 1 Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve shërbimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), përshkrimin e shkurtër te vendit te punës dhe nënshkrimi I punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, për secilin punëtor te prezantuar ne liste duhet te dëshmohet, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, marrëveshja duhet te jete e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03 L-212;

Pra në bazë të dëshmisë, GOE është dashur ta dorëzojë Listën e punëtorëve me të dhënat si: Profesioni, Eksperiencia etj.

GOE e ka dorëzuar një Listë e cila nuk përmbushë kërkesat e FDT:

LISTA E PUENSUARVE
"GZIMI-GARTEN UND LANDSCHAFTSBAU" SHPK

Gzimi Garten -Und Landesch		Rahovec,R.Kosoves		Rahovec			
N.Fiskal: 810733106		NRB: 70555352					
Emri	Mbiemri	IDPersonale	Nënskrimi	Di Lindjes	Vendi i Lindjes	Adresa	Titulli
ADONIS	TARA	1002482939		17.11.1982	Rahovec	Bekim Syka	Manager Projektit
BAKI	SHALA	1003677911		25.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor
BLENDAR	FERATI	1248079742		22.06.1985	Rahovec		Puntore
PETRIT	VELIU	1003674912		11.03.1976	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Menager
LIRIDON	PALLQA	2170107627		06.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor
LUAN	HOTI	1007636306		25.09.1972	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
ALI	SHTAVICA	1248096358		15.08.1999	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
HAMIDE	VELIU	1249341424		04.03.2002	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntore
Sedik	Cana	1002403613		24.07.1979	Rahovec	Uck-se	Puntor
SABINA	DURGUTI	1170687139		13.04.1986	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntore
BENJAMIN	REKHA	1243902491		15.09.1995	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
ELFRID	SHTAVICA	1171454600		25.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor



Për më tepër AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së (Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), sepse një OE e ka eliminuar

pikërisht për këtë qështje. Pra GOE të rekomanduar e ka vlerësuar se e plotëson këtë kërkesë edhe pse nuk e ka Listën e punëtorëve

me të dhënat e kërkuara, ndërsa GOE Milazim Bala B.I dhe Capital XFET, e ka eliminuar pikërisht për këtë Listë:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur **me pretendimin tuaj ankimor**, për Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë **është i pabazuar**.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, keni cekur: *Për më tepër AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së (Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), sepse një OE e ka eliminuar.*

pikërisht për këtë qështje. Pra GOE të rekomanduar e ka vlerësuar se e plotëson këtë kërkesë edhe pse nuk e ka Listën e punëtorëve

me të dhënat e kërkuara, ndërsa GOE Milazim Bala B.I dhe Capital XFET, e ka eliminuar pikërisht për këtë Listë:

“Pra GOE të rekomanduar e ka vlerësuar se e plotëson këtë kërkesë edhe pse nuk e ka Listën e punëtorëve” Operatori Ekonomik e ka dorëzuar Listën e Numrit të Punëtorëve sipas Kërkesës Nr. 1 të Kapacitetit teknik dhe profesional, duke bashkangjitur dhe kontrata e punës;

“ndërsa GOE Milazim Bala B.I dhe Capital XFET, e ka eliminuar pikërisht për këtë Listë”

Në **Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, kemi sqaruar: Në ofertën e juaj të dorëzuar, lista e numrit të punëtorëve të prezantuar nga ana juaj NUK është plotësuar sipas Kërkesës së AK-së, në listë mungon: **mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), përshkrimin e shkurtër të vendit të punës dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë listë;**

Lista e Punëtorëve të dorëzuar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik ankues është:**

Lista e Punetoreve							
Nr	Emri	Mbiemri	Mosha	Profesioni	Eksperiencia	Pozita ne Kompani	Nenshkrimi
1	Indrit	Krasniqi	27.06.2001	Ekonomist	4 vjet	Punetore	
2	Hana	Haxhijaha	23.05.2001	Stomatologe	5 vjet	Menaxhere	
3	Ilirjana	Krasniqi	01.01.1978	Punetore	15 vjet	Punetore	
4	Veli	Paqarrizi	19.05.1996	Punetore	10 vjet	Punetore	
5	Hysen	Qmega	03.03.2001	Punetore	3 vjet	Punetore	

OE PASTER IN SH.P.K.



Ku në këtë Listë është **edhe Pronare e Kompanisë** dhe nuk mund të llogaritet si punëtorë e Kompanisë

Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Hana Haxhijaha
------------------------	----------------

Po ashtu në Listën e punëtorëve është edhe **Iirjana Krasniqi**, ku e njëjta është punëtore e Komunës, dhe në aktivitetin e prokurimit: *Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës*, në Kërkesën Nr. 3 kemi kërkuar: *Operatori Ekonomik obligohet që të punësoi minimum: 26 punëtorët nga Lista e Autoritetit Kontraktues* dhe në këtë listë është edhe punëtorja në fjalë, e cila është e angazhuar tek Kompania për pastrimin e objekteve të Komunës: N.SH.H."ZONA PARK", ku kontrata është aktive. E njëjta është edhe tek Kompania ankuese, dhe ne si AK do ti drejtohem institucioneve tjera përkatëse, me qëllim mbrojtjen e të drejtave tona ligjore dhe sigurimin e zbatimit të drejtë të ligjit. Pretendimi juaj në këtë **pikë është i pabazuar**;

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

PRETENDIMI NR.4

Pretendimi nr.4 ka të bëjë me Deklaratën e Grupit të Operatorëve Ekonomik të dorëzuar nga GOE I rekomanduar, e cila është kërkuar

që të Plotësohet conform nenit 11.1 të Dosjes së Tenderit:

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimin të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit , në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7 Deklarata për themelimin të grupit, është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.
---	------	--

GOE e kanë dorëzuar formën sipas ANEKS 7 të Dosjes, por të njëjtën NUK E KANË plotësuar me të dhënat e kërkuara sin ë Dekleratë !!!.

Në pikën 5 të Dekleratës për themelimin e Grupit është kërkuar që Anëtarët e Grupit të OE, të deklarojnë % e pjesëmarrjes së tyre në

grup.

GOE në deklaraten e dorëzuar, NUK e kanë plotësuar fare këtë kërkesë të Dekleratës dhe të pikës 11.1 të FDT:

5. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është;

a) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës se Liderit]

b) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës e anëtarit]

Shto sipas nevojës

Pra me mos plotësimin e Dekleratës së Grupit të OE, ky GOE është dashur të eliminohet e jo të rekomandohet për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Ju sqarohet se lidhur **me pretendimin tuaj ankimor**, për Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë **është i pabazuar**.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatori Ekonomik e ka plotësuar **Aneksin 7 Deklarata për themelim te grupit** sipas Dosjes se tenderit, në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimit të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimi juaj në këtë **pikë është i pabazuara**;

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundet të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>